

ÇKA DEMOKRACIA?



JEMI DHE TRAJTOHEMI NË MËNYRË TË BARABARTË

ARTMIR (12), DELVINË (12), VLERA (12), MERITA (12)



Grupi ynë sot do të jetë udhërrëfyese i të gjithë lexuesve të kësaj gazete. Në artikullin tonë do të keni rastin të informoheni për demokracinë por po ashtu edhe për qytetarinë aktive. Se pse është e rëndësishme demokracia dhe se si mund të jenë qytetarët aktiv në këtë sistem të qeverisjes

Çka mendoni se është demokracia dhe cilat janë disa nga elementet e saja? Me këtë pyetje filloi diskutimi brenda anëtarëve të grupit tonë.

Demokracia është sistem i qeverisjes ku të gjithë qytetarët pa dallime, trajtohen në mënyrë të barabartë. Po të mos ekzistonte demokracia, pa dyshim që nuk do t'i njihnim as elementet që e bëjnë demokracinë edhe më unike. Nëse nuk do kishte demokraci, sot shoqja jonë Delvina nuk do të kishte mundësi t'i shprehte lirshëm mendimet e saj. As ne të tjerët nuk do t'i gëzonim të gjitha këto të mira që sot i gëzojmë. Për të kuptuar më mirë se cilat të mira i gëzojnë qytetarët në demokraci, edukatorja jonë na ndau në dy grupe. Grupi i cili përfaqësonte sistemin diktatorial, si dhe grupi i cili përfaqësonte sistemin demokratik. Anëtarë të sistemit diktatorial ishin Artmiri, Delvina dhe edukatorja jonë. Kurse, unë Merita dhe Vlëra ishim pjesë e sistemit të demokracisë. Unë dhe Vlëra çdo gjë që e bënim e bënim me shumë përkushtim. Për më tepër, Vlëra propozoi që ne së pari të shkruanim artikullin, pastaj të vazhdonim me vizatime. Sigurisht, që edhe unë e tregova mendimin tim, së pari të vizatojmë, pastaj të shkruajmë artikullin. Ishin dy mendime të ndryshme, por ajo çka bëmë ne ishte zgjedhja symbyllurazi. E kështu të dyja ishim të kënaqura, sepse e respektonim

mendimin e njëra-tjetrës. Ndërsa, po t'i shihnit shokët tanë të sistemit diktatorial, aty ishte shumë ndryshe prej neve. Askush nuk ishte i lirë të shprehte mendimin e vet. Ishte Delvina ajo e cila iu tregonte se çka duhet të bënin edukatorja dhe Artmiri. Ata disi ishin edhe pa vullnet. E kur edukatorja e pa që sa të lumtura ishim ne dyja, ajo na tha që kështu janë shtetet që kanë sistem demokratik të qeverisjes. Për këtë, ky sistem është i dashur nga të gjithë, sepse të gjithë trajtoheni në mënyrë të barabartë dhe secili ka vlerën e vet. Andaj, shokë dhe shoqe të dashura, le të jetojmë me demokracinë. Ta duam dhe t'i respektojmë elementet e saj: tolerancën, solidaritetin, barazinë, e shumë të tjera. Ne jemi pjesë e saj. Prandaj, na takon ta duam.



Ne trajtohem i të barabartë me ju

Në këtë faqe do t'iu tregojmë se si mund të jemi ne nxënësit e shkollave fillore aktiv. Më konkretisht, do t'iu informojmë rreth punës që ne në Qendrën „Shtëpia e Shpresës“ bëjmë. Ajo çka ne si anëtarë të kësaj Qendre shpresojmë është që ju të dashur lexues të pëlqeni sado pak punën tonë. E pse jo të na bashkoheni edhe ju? Qendra ka nevojë për qytetarë aktiv dhe me ide kreative

Grupi ynë sot diskutoi për dy tema mjaft atraktive, por edhe të dashura për qytetarët. Ne u munduam deri në maksimum, që të gjithë ato që i mësuam t'i paraqesim tek ju, qoftë me anë të shkrimeve, qoftë me anë të vizatimeve. Kjo në mënyrë që edhe ju të mësoni aq sa mësuam ne sot. Po ashtu, të mësoni edhe për punën tonë që si nxënës aktiv e bëjmë. Aktiviteti i fundit që ne kemi bërë ishte pikturimi i murit në sallën e takimeve. Kemi vendosur ta pikturojmë, sepse të gjitha takimet e rëndësishme për Qendrën dhe për neve mbahen në atë sallë. Dukej më bukur për sy dhe na rriste motivin më shumë për punë. Përpos këtij murali, ne po ashtu kemi bërë edhe pikturimin e disa gjetheve. Në ato gjethe kemi shkruajtur fjalë në gjuhën angleze, sepse Qendra vizitohet edhe nga qytetarë të vendeve evropiane. Këtë veprim e kemi bërë si shenjë falënderimi. I cekëm vetëm këto dy aktivitete, mirëpo këto nuk janë

të vetmet që ne i kemi bërë. Në fakt, janë plot të tjera. Me tregimin e këtyre dy veprimeve, ne vetëm deshëm t'iu tregojmë që edhe pse nuk jemi të moshës madhore, ne fëmijët kemi ndikim shumë pozitiv në shoqëri. Meqë jemi tek ndikimi, duam t'iu tregojmë edhe një rast. Para disa muajve të gjithë anëtarët e Qendrës jemi mbledhur dhe kemi pastruar tërë lagjet e fshatit tonë, Milloshevës.

Gjatë kohës sa ishim duke bërë mbledhjen e mbeturinave, hasnim në qytetarë të ndryshëm. Ata u gëzuan shumë që ne po kujdesemi për ambientin, por njëri nga shokët tanë iu drejtua: „Ne po e pastrojmë sot, por që të jetë fshati i pastër çdo ditë, duhet të kujdeseni edhe ju, të gjithë së bashku“. Ata na premtuan që do të kenë më shumë kujdes. Pastaj, ne vazhduam punën me më shumë vullnet e entuziazëm. Puna jonë pati ndikim pozitiv.



Këtu kemi paraqitur disa qytetarë aktiv. Së pari ata mendojnë se çka ka nevojë të përmirësohet në vendin e tyre



Pasi diskutuan, qytetarët morën një vendim që do të ndaheshin në grupe për të pastruar ambientin e tyre

ATY KU NJOHIM NJËRI-TJETRIN

MEHREME (12), ERINA (12), VALËZA (12), ARDIAN (13)




Pasi që ne sot kemi mësuar rreth medias dhe demokracisë, kemi vendosur të shkruajmë këtë artikull që edhe ju lexues të kuptoni më shumë rreth këtyre dy temave

Fillimisht do të flasim për demokracinë. Kjo fjalë ka kuptimin e një populli udhëheqës. Qytetarët e këtyre vendeve vendosin me dëshirë dhe vullnet të lirë për veten dhe vendin e tyre. Për dallim, diktatura është udhëheqje e një personi të vetëm, ku fjala e lirë nuk ekziston fare. Në demokraci secili qytetar gëzon të drejtën e votës së lirë. Ne votojmë kandidatët, për të cilët mendojmë se janë të denjë për vendin ku jetojmë dhe veprojmë. Shpeshherë mund ta kemi të vështirë të vendosim cilin kandidat ta votojmë. Por, përmes medias ne marrim informata të nevojshme për ta bërë përzgjedhjen tonë. Kjo do të thotë se media është shumë e fuqishme dhe ndikon shumë në një vend.

Ardiani sot na tregoi që babai i tij në zgjedhjet e kaluara kishte votuar një kandidat të caktuar. Pas zgjedhjeve, babai i Ardianit nuk ishte ndalur dhe kishte përcjellur të gjitha seancat e Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, deputeti i zgjedhur, sipas babait të Ardianit, nuk ishte treguar përfaqësues i mirë.

Prandaj, në zgjedhjet e ardhshme ai do të votojë për një kandidat tjetër. Babai i Ardianit ka përdorur median si formë të marrjes së informatave. Megjithatë media nuk ka qenë gjithmonë siç është tani. Shumë kohë më parë, njerëzit kanë komunikuar përmes letrave, të cilat i kanë dërguar me anë të pëllumbave postierë. Gjithashtu ata kanë sinjalizuar të tjerët përmes tymit të zjarrit për ndonjë rrezik të mundshëm.



Media kudo në jetën dhe mendjen time

Kjo mënyrë e komunikimit ka marrë shumë kohë dhe ka qenë shumë kufizuese, sepse nuk kanë mundur të njohin të tjerët. Me kohë, gazeta është bërë mjeti i parë prej së cilës njerëzit kanë marrë informata. Ndërsa, interneti është mjeti më i fundit prej të cilit njerëzit jo vetëm që marrin informata, por njëkohësisht edhe i transmetojnë ato tek të tjerët.

Sot, njerëzit anembanë botës, për shkak të zhvillimit të teknologjisë janë bërë shokë me njëri-tjetrin. Kjo mundësohet vetëm në një vend ku ka demokraci.



Ne jemi gazetarët e së ardhmes

KUVENDI NË JETËN TIME

ANESA (13), DIAGNESA (12), ARBËR (13), BLEND (13)



Sot kuptuam rëndësinë e madhe që ka Kuvendi i Kosovës në jetën tonë si nxënës dhe si qytetarë

Më 20 nëntor 2008 deputetët e Kuvendit të Kosovës miratuan ligjin për ngrohje. Sipas këtij ligji, qytetarëve të qendrave urbane me dendësi më të madhe, u sigu-




rohet ngrohje gjatë sezonit të ngrohjes. Kjo është bërë me qëllim që ngrohja të jetë më e lehtë për qytetarët, gjatë stinës së dimrit. Ligjet që miratohen në Kuvend, miratohen për ta lehtësuar dhe rregulluar jetën tonë. Prandaj, Kuvendi është kaq i dashur për ne. Ky funksion i miratimit të ligjeve, njihet si funksioni legjislativ i Kuvendit. Deputetët përmes miratimit të ligjeve, mundohen të sistemojnë jetën tonë. Në këtë mënyrë, ne jetojmë në barazi dhe në liri. Për shembull, ligji për barazinë thotë se të gjithë qytetarët janë të barabartë

në demokraci. Kjo është arsyeja pse të gjithë ne pa dallime, kemi të drejtë të shkojmë në shkollë, të mjekohemi, të marrim patentë shoferin, etj. Në të kaluarën ka qenë më e rrallë që gratë të vozisnin veturën. Mirëpo, sot, ky dallim nuk ekziston. Kjo falë ligjeve që i kemi dhe falë Kuvendit. Funksion tjetër i Kuvendit është funksioni përfaqësues. 120 deputetët të cilët e ushtrojnë këtë funksion janë përfaqësues dhe zëri i popullit në Kuvend. Andaj, themi se Kuvendi ka funksion përfaqësues. Si dhe funksioni i tretë është funksioni kontrollues. Kuvendi kontrollon Qeverinë nëse ky institucion është duke i zbatuar ligjet. Roli i tij është shumë i madh për të gjithë ne. Sot e kuptuam këtë gjë, ngase më herët nuk e kemi menduar rëndësinë e tij për ne. Shpresojmë që e kuptuat edhe ju, përmes këtij artikulli të shkruar nga ne.



Autorët demokratikë të këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
Qendra: „Shtëpia e Shpresës“
Klasa: VII & VIII
Vendi: Mitloshevë, Obiliq